



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.332/24

Datë: 14.05.2024

Duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar të Republikës e Kosovës, nenit 37 të Ligjit Nr.08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, Udhëzimit Administrativ Nr.22/2013 për Numrin Maksimal të Nxënësve në Klasë dhe Raporti Mësimdhënës Nxënës, si dhe Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.9/2023 për Regjistrimin e Fëmijëve në Klasën e Parë në shkolla, Drejtori Komunal i Arsimit në Istog, shpall këtë:

K O N K U R S PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E PARË (I) DHE PARAFILLOR NË SHKOLLA PËR VITIN SHKOLLOR 2024/25

Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë dhe parafillor për vitin e ri shkollor 2024/25 fillon me datën 15.05.2024, në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Istogut dhe zgjatë deri me 15.06.2024.

Kriter për regjistrim të nxënësit/ës në klasen e parë dhe parafillor është që fëmija të ketë mbushur moshën minimale (gjashtë vjet për klasë të parë) dhe (pesë vjet për parafillor) por mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arsimit të detyruar në fillim të vitit shkollor duke u bazuar në kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ MASHT Nr.9/2023 për Regjistrimin e Fëmijëve në Klasën e Parë.

Dokumentacioni i kërkuar për regjistrim.

Për regjistrim në klasë të parë dhe parafillor, fëmiju (Prindi) duhet të sjellë certifikatën e lindjes/ekstraktin, certifikatën e vaksinimit dhe certifikatën e vendbanimit e cila nuk është me e vjetër së 6 muaj.

Institucionet arsimore të cilat regjistrojnë fëmije në klasë të parë obligohen që ti përmbahen Udhëzimit Administrativ MASHT Nr.9/2023 për Regjistrimin e Fëmijëve në Klasën e Parë.

Informatat për procedurat e nevojshme për regjistrim mund t'i merrni në shkollat më të afërta nga vendbanimi.

